



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr.80, Datë, 23.03.2021

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016 bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 23.03.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 38/2 prot., datë 18.03.2021, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për licencimin e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatohet se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 444 prot., datë 12.03.2021, shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria ka kryer pagesën e regjistrimit për aplikim, për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, sipas Aneksit A, të Rregullores së licencimit.
- Aplikimi i shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”). **Plotësuar në mënyrë korrekte.**

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”), **Plotësuar në mënyrë korrekte.**
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a” dhe “d”). **Plotësuar në mënyrë korrekte.**
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.7 gërmat “a”, “c”, “d”, “g”). **Plotësuar në mënyrë korrekte.**

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2:
 - gërma “d”: (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). **Plotësuar pjesërisht;** Shoqëria duhet të përcjellë në ERE, Vërtetimet e prokurorisë dhe gjykatës së Tiranës për administratorin e shoqërisë dhe po ashtu edhe Vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë së qarkut Kukës, për shoqërinë dhe administratorin e saj. Kjo shoqëri ka seli edhe në adresë në këtë qark.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3:
 - gërma “b”: «Paraqitje bilanci financiar të tre viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilanci të këtyre të fundit)». **Plotësuar pjesërisht;** Shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., duhet të depozitojë në ERE versionin final dhe të audituar të Pasqyrave financiare për vitet 2017, 2018 dhe 2019.
 - gërma “c”: «Dokumenta që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj)». **Plotësuar pjesërisht;** Shoqëria duhet të përcjellë në ERE dokumentacion mbështetës sipas kërkesave të kësaj pike të Rregullores.
- Dokumentacioni Teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, Neni 9, pika 4.7:
 - gërma “b”: «Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj)». **Plotësuar pjesërisht;** Shoqëria duhet të depozitojë sa kërkon kjo pikë e Rregullores.
 - gërma “e”: (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi) **Pa plotësuar;** Shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., duhet të dokumentojë në ERE sistemin IT me të cilin do të operojë në vijim.
 - gërma “g”: (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do ti ofrohen klientëve.) **Pa plotësuar.** Shoqëria duhet të përcjellë dokumentacion, sipas kërkesave të kësaj pike të Rregullores, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI